

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kapja e 22 ton dr'ogë, mediat e Ekuadorit: Mafia shqiptare tentoi të korruptonte agjentë të inteligjencës
ADRESA	https://lajmifundit.al/kapja-e-22-ton-dr-oge-mediat-e-ekuadorit-mafia-shqiptare-tentoi-t-e-korruptonte-agjente-te-inteligjences-i1339094
BURIMI	lajmifundit.al
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 09:02:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 10:48:45 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e62cc6bf11f977ec03dc15378d4ed6d1962d0a4fef6ca71032080a28b03dfe64
TEKSTI	ff7f8a82e150972277ab1931abbf14c6f5bd3c498a77f2a5aff1a5ed371ff35d
PAMJA	2167cd522eee0018dae0d062e78d27fe5049d8c31cb15310d1be06abe8d48f80

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5063704c9b6628632966e8bb8edc3ad60582e01660ee47a6f4352f10ed25554a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5542c6f376d7530e05241a95b291e64e02f5f89d799222f37a26423635f8fe31
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5063704c9b6628632966e8bb8edc3ad60582e01660ee47a6f4352f10ed25554a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kapja e 22 ton dr'ogë, mediat e Ekuadorit: Mafia shqiptare tentoi të korrupsonte agjentë të inteligjencës

[Lexo lajmin e plotë](#) →

Tragjike, goditi kokën gjatë ndeshjes, ndërron jetë 16-vjeçari shqiptar në Greqi (EMRI)

[Lexo lajmin e plotë](#) →

Ndezi zjarr për të djegur mbeturinat, flakët shkaktuan dëme të mëdha, pranga 31-vjeçarit në Fier

[Lexo lajmin e plotë](#) →

Kompania që prodhoi vaksinat kundër koron'avirusit mbyll tri fabrikat e saj në Gjermani

[Lexo lajmin e plotë](#) →

Alarm për dimrin 2026-2027, temperaturat në nivele të pazakonta, çfarë pritet të ndodhë?

[Lexo lajmin e plotë](#) →

Kapja e 22 ton dr'ogë, mediat e Ekuadorit: Mafia shqiptare tentoi të korrupsonte agjentë të inteligjencës



LAJMI FUNDIT / 29 SEPTEMBER 2026, 10:48

Shpërndaje

BOTA



Nga Ecuavisa

Që nga viti 2009 ka gjurmë publike të mafies shqiptare në Ekuador. Një nga figurat kriminale më të ekspozuara ishte Dritan Rexhepi, i cili u arratis nga vendi pasi përfitoi nga lirimi i parakohshëm në vitin 2021. Pasuesi i tij ishte Dritan Gjika, i përfshirë në pastrim parash. Hetimet ndaj rrjetit ballkanik nxorën në pah infiltrimin e tij në disa institucione, përcjell Shekulli.

Mafia shqiptare ka më shumë se 15 vjet që është vendosur në Ekuador. Sipas të dhënave policore dhe gjyqësore, anëtarët e këtij rrjeti të trafikut të drogës filluan aktivitetet e tyre që nga viti 2011, duke krijuar kompani fiktive, lidhje me banda kriminale lokale dhe duke shtrirë tentakulat e tyre në institucione publike si Policia, Forcat e Armatosura, Doganat, SNAI (sistemi i burgjeve dhe qendrave të riedukimit), ndër të tjera, për të transportuar tonelata droge drejt Evropës.

Më 21 shtator 2026, u bënë të njohura lidhjet e mafias shqiptare me sistemin shëndetësor. Tetë persona, mes tyre ish-mjekë publikë dhe një zyrtar i SNAI-t, u ndaluan nga autoritetet, pasi dyshohet se i kishin dhënë ndihmë shqiptarit Dritan Rexhepi përmes certifikatave dhe kishin krijuar përshtypjen sikur kreu i mafies vazhdonte të ishte në Ekuador.

Rexhepi, i kapur në Turqi në vitin 2023 dhe i ekstraduar një vit më parë në Shqipëri, ishte një nga shqiptarët e parë që krijoi lidhje dhe një perandori të trafikut të drogës. Pasuesi i tij ishte Dritan Gjika, i arrestuar në Emiratet e Bashkuara Arabe në vitin 2025 dhe ndaj të cilit në Ekuador janë dy hetime penale për pastrim parash dhe krim të organizuar.

LEXONI GJITHASHTU

MOTI NE TIRANE

Tirana, Albania

POLITIKË

Skandali i SHISH-it/ Klosi: Sulme personale që godasin insitucionet në mënyrë të padrejtë...

POLITIKË

A është i zhgënjyer nga politika? MC Kresha flet pa dorashka

TRENDING

Destinacioni sekret: Wizz Air sjell në TIA 150 influencues dhe gazetarë për të zbuluar Shqipërinë

Kryeministri Rama në New York: Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës, dëshmi e transformimit të Shqipërisë



Tragjike, goditi kokën gjatë ndeshjes, ndërron jetë
16-vjeçari shqiptar në Greqi (EMRI)



Ndezi zjarr për të djegur mbeturinat, flakët
shkaktuan dëme të mëdha, pranga 31-vjeçarit në Fier



Kompania që prodhoi vaksinat kundër koronavirusit
mbyll tri fabrikat e saj në Gjermani

Rrjeti shqiptar dhe ballkanik ka pasur edhe anëtarë të tjerë të njohur në vend, të cilët janë bërë publikë përmes hetimeve ose vrasjeve që nga viti 2017, në qendra tregtare apo komplekse banimi private. ECUAVISIA mbledhi të dhënat se si u shtrinë tentakulat e mafies shqiptare.

Dritan Rexhepi, një nga bosët kryesorë shqiptarë në Ekuador

Prania e mafies shqiptare në Ekuador mori hov që nga viti 2011, me mbërritjen e Dritan Rexhepit. Ai u arratis nga autoritetet shqiptare dhe italiane dhe kërkoi strehim në këtë vend.

Anëtar i kartelit Kompania Bello, ai u vendos në Guajakil nën maskën e një biznesmeni, pasi ishte arratisur nga një burg në Belgjikë. Fliste mirë spanjisht dhe italisht, ndaj e kishte më të lehtë të komunikonte.

Kështu veproi në anonimat për tre vjet. Ai ndërtoi një sistem të sofistikuar logjistik, duke rekrutuar punonjës portualë, persona në kompanitë e transportit detar, agjentë doganorë dhe policë, gjë që mundësoi akses të sigurt në kontejnerët që dërgoheshin drejt Evropës, sipas një hetimi të portalit Código Vidrio.

Por në vitin 2014, Rexhepi u arrestua së bashku me anëtarë të organizatës së tij dhe u akuzua për trafik droge. Shqiptari përdorte edhe dy identitete të tjera në vend, njëri prej tyre Lulzim Murataj. Më pas, ai u dënua me 13 vjet burg.

Fillimisht qëndroi në burgun e Guajakilit dhe më pas u transferua në burgun Rajonal të Kotopaksit. Në atë burg krijoi miqësi me Jorge Zambranon, i njohur me nofkën Rasquiña dhe kreu i Los Choneros. Pavarësisht se ishte në burg, ai vazhdoi biznesin e paligjshëm të trafikut të drogës.

Në vitin 2021, qeveria e Italisë filloi procedurën për ekstradimin e tij, diçka që Rexhepi dëshironte ta shmangte. Po atë vit, pasi kishte vuajtur pak më shumë se 67% të dënimit, kërkoi arrest shtëpie. Ai pretendoi se vuante nga sëmundje si lupusi dhe probleme kardiale. Disa muaj më vonë përfitoi nga lirimi i parakohshëm, i cili konsistonte në paraqitje periodike dhe ndalimin e largimit nga vendi.

Rexhepi po i zbatonte këto masa deri në nëntor 2021, kur filloi të paraqiste certifikata mjekësore për të justifikuar mungesat e tij. Pesë vjet më vonë, autoritetet deklaruan se këto dokumente ishin të falsifikuara dhe pjesë e një skeme brenda sistemit publik shëndetësor.


Specialistët e përmendur nga autoritetet ende nuk janë proceduar penalisht. Njëri prej tyre publikoi një video ku siguroi se nuk kishte firmosur kurrë një certifikatë të shqiptarit, gjë që rezultoi në dokumentet e shqyrtuara nga Ecuavisa.com, dhe se ishte vetëm i ndaluar për të dhënë deklaratë. Ky rast ndodhet në fazën e hetimit paraprak.

Para Rexhepit, Arbër Çekaj

Para Rexhepit në Ekuador, shqiptari Arbër Çekaj merrej me trafikun e drogës. Ai mbërriti në vend në vitin 2009, sipas një raporti të Plan V.

Në vend, në vitin 2012, ai themeloi një kompani falë një kredie bankare dhe filloi të dërgonte banane në Shqipëri. Vetëm brenda një viti, ai dërgoi 1.000 tonë nga ky produkt.

Midis vitave 2009 dhe 2015, ai bëri në Ekuador të paktën 10 herë dhe sekto si Bankari i Kështre



POLITIKË

FOTOLAJM/ U komandua në krye të SHISH pas shkarkimit të Hysenit,
Elvis Lila për herë të parë në publik



POLITIKË

Kryeministri mbledh drejtuesit e PS-së dhe ministrat/ Zbulohet fokusi i takimit

ME TE LEXUARAT

"Zbrazti karika'torin ndaj shqiptarëve që i hynë në shtëpi" – Mediat italiane: Jeta e "dyfishtë" e...

[Lexo lajmin e plotë](#)

Euron pëson rënien si asnjëherë më parë, me sa tregtohet sot, këmbimi valutor 23 shtator 2026

[Lexo lajmin e plotë](#)

Skandali "Xhaka" merr përmasa të tjera, mjekja del kundër kapitenit: E kam vaksinuar vetë

[Lexo lajmin e plotë](#)

Zbulohet e vërteta për Bleona Matën, avokati: E ëma në gjendje të rëndë! A ndodhet në Greqi?!

[Lexo lajmin e plotë](#)

midis viteve 2009 dhe 2019, atyherë në Ekuador të paketi i tyre u ngrit dhe ashtu si Rexhepi, kishte të numra pasaportash. Sipas hetimeve, ai dërgoi banane me 18 kompani të vendit, tre prej të cilave kishin precedentë për zbulime droge.

Anonimati i tij përfundoi në vitin 2015, kur u përpoq të përdorte një fermë për të paketuar drogë në kuti bananesh dhe punonjësit telefonuan Policinë.

Çekaj nuk u arrestua në Ekuador, pasi u arratis nga vendi pesë ditë para se të akuzohej penalisht. Në vitin 2018 u procedua në Shqipëri, ku policia gjeti 613 kilogramë kokainë në një nga ngarkesat e tij.

Gjika, pasuesi i Rexhepit, pastroi më shumë se 40 milionë Dollarë

Me rënien e Rexhepit në Ekuador, në skenën kriminale u shfaq një tjetër shqiptar: Dritan Gjika. Edhe ai u vendos në vend duke përfituar nga lehtësitë migratore, siç është shtetësia universale dhe u paraqit si biznesmen.

Gjika krijoi rreth dhjetë kompani të lidhura me ndërtimin, eksportin e bananeve, bujqësinë, ndër të tjera. Katër prej kompanive vazhdonin të ishin aktive deri në vitin 2024, megjithëse tashmë kishte hetime në zhvillim, siç ishte rasti Pampa kundër shqiptarit.

Prokuroria akuzoi se rrjeti i Gjikës pastroi 31 milionë USD midis viteve 2015 dhe 2024, vit kur iu kontrollua banesa në një zonë ekskluzive të Samborondón. Sipas hetimeve të Policisë, Gjika ishte në krye të të gjithë procesit të trafikut të drogës, që nga miratimi i porosive për kokainë në laboratorët e Kolumbisë, deri të përfundimi i shitjeve në Evropë dhe gjurmimi i mënyrës se si pastroheshin paratë përmes blerjes së pronave, automjeteve etj.

Struktura e shqiptarit bashkëpunonte me gueriljen e FARC-ut dhe me Los Choneros, për të përcaktuar rrugët nëpër të cilat transportohej droga drejt porteve. Kokaina, njësoj siç vepronin Rexhepi dhe Çekaj, fshihej në kuti bananesh me destinacion Spanjë, Belgjikë, Holandë, Turqinë dhe Shqipërinë.

Për t'iu shmangur kontrolleve, ata kishin informacion të privilegjuar mbi dokumentet detare të tregtisë së jashtme, gjë që lehtësonte kontaminimin e disa kontejnerëve në javë. Gjika u akuzua në Ekuador për krim të organizuar dhe pastrim parash.

Ai është në statusin e të arratisurit dhe gjyqet kundër tij do të aktivizohen kur të ekstradohet në Ekuador. Ndaj tij kishte dy njoftime të kuqe të Interpolit, një në Ekuador dhe një në Spanjë. Aktualisht, ai mbahet i arrestuar në Abu Dhabi që nga qershori i vitit 2025.

Infiltrimi i mafias shqiptare në Polici, Forcat e Armatosura, SNAI dhe institucione të tjera

Dosjet kundër shqiptarëve Rexhepi dhe Gjika nxorën në pah lidhjet e mafias me pjesëtarë të forcave publike dhe institucione si SNAI ose Shëndetësia. Përveç kësaj, ajo ishte e përfshirë edhe në qarqe biznesi.

Një oficer i Policisë i tha ECUAVISA se, nën maskën e tregtarëve, shqiptarët filluan të krijonin marrëdhënie me biznesmenë, ushtarakë, politikanë, policë, prokurorë, gjyqtarë dhe persona me ndikim në Ekuador. Në aspektin sentimental, ata kërkonin si të dashura kandidatet për kurorat e konkurseve të bukurisë.

Përveç kësaj, ata u bënë donatorë të disa institucioneve. Sponsorizonin kampionate volejboli, futbollit dhe aktivitete lokale, për t'u bërë pjesë e komunitetit si "biznesmenë të bananeve". Pasi fituan fuqi ekonomike, sipas oficerit, shqiptarët investuan në ferma karkalecash dhe kompani të tjera. Për t'u fshehur, filluan të përdornin persona të tjerë si pronarë formalë.

Ndër shembujt e infiltrimit të mafias shqiptare në institucione të ndryshme është rasti i 21 shtatorit 2026, i cili zbuloi rrjetin e mjekëve që dyshohet se favorizuan Rexhepin.

Një tjetër rast ishte në vitin 2024, kur Forcat e Armatosura sekuestruan 22 tonë kokainë në një fermë në Los Ríos, me vlerë 660 milionë USD.

Prokuroria zbuloi se mafia shqiptare u përpoq të korruptonte agjentë të inteligjencës, duke u ofruar

shokëve të tyre 100.000 USD për të mësuar se kush kishte zbuluar vendndodhjen e ngarkesës.

Kësaj i shtohet edhe një rrjet trafikimi karburantesh i drejtuar nga pjesëtarë të Policisë, të cilët korruptonin uniformat e kësaj strukture dhe ushtarakë, në mënyrë që të mund të nxirnin karburant nga poliduktet. Ata paguanin nga 1.000 deri në 2.000 USD për informacion mbi kontrollet, operacionet dhe për të shoqëruar kamionët me benzinë të vjedhur.

Në vitin 2017, kur u vra shqiptari Ilir Hidri, Prokuroria kontrolloi telefonin e tij. Në pajisje kishte biseda me persona që dyshohej se ishin pjesëtarë të Policisë Kombëtare, të cilëve u kërkonin informacion për një agjent të caktuar.

Mafia shqiptare – në ato vite – kërkonte kontakte në Njësinë e Porteve dhe Aeroporteve (UIPA), Antinarkotikët dhe madje edhe Dinased.

Gjashtë shqiptarë, serbë dhe malazezë të vrarë në Ekuador që nga viti 2017

Mafia shqiptare vepron me shtetas kosovarë dhe malazezë, të cilët gjithashtu kanë mbërritur në Ekuador në raste të ndryshme. Sipas hetimeve të kryera nga Prokuroria dhe Policia, një nga partnerët kryesorë të Gjiks ishte kosvari Remzi Azemi.

I huaji u përmend si i dyshuar për vrasjen e një shqiptari dhe të një malazezi, të ndodhura përkatësisht në vitet 2017 dhe 2018. Azemi u procedua për vrasje në vitin 2019, por u dërgua vetëm në gjyq, pasi në Ekuador nuk mundi të arrestohej.

Ai u akuzua për vrasjen e një malazezi, Fadil Kacanici, dhe bashkëshortes së tij ekuadoriane në rrugën drejt bregdetit. Të dy u rrëmbyen nga shtëpia e tyre në Guajakil gjatë një operacioni të rremë policor dhe u gjetën të ekzekutuar në anë të rrugës.

Mes shqiptarëve të tjerë të vrarë është Ilir Hidri, në vitin 2017, në jugperëndim të Guajakilit, i cili ishte ortak i Azemit. Në vitin 2020 u vranë Adriatik Tresa, brenda shtëpisë së saj në Samborondón, dhe Sasha Spasiç, në një qendër tregtare.

Në vitet 2022 dhe 2023, dy shqiptarë të tjerë vdiqën pasi u qëlluan me armë. Një nga rastet ndodhi në një restorant dhe tjetri jashtë një spitali në Guajakil.

Prokurori César Peña hetoi disa prej këtyre vrasjeve, si atë të Ilir Hidrit dhe të malazezit. Ai deklaroi se mafia shqiptare kryen krimet kryesisht për larje hesapësh.

Përveç shqiptarëve të përmendur më sipër, pjesëtarë të tjerë të këtij rrjeti të trafikut të drogës janë arrestuar në operacione të përbashkëta, por në vende si Spanja. Deri tani, autoritetet nuk kanë bërë publike figura të tjera të këtij klani në vend.

Kreu i fundit i mafias i lidhur me këtë rrjet dhe i bërë publik është serbi Jezdmir Srdan, i cili ndodhet në burgun El Encuentro.

ME TË LEXUARAT

“Zbraz karika'torin ndaj shqiptarëve që i hynë në shtëpi” – Mediat italiane: Jeta e “dyfishtë” e Gjovalin Lazrit

[Lexo lajmin e plotë](#)

NA SHKRUAJ

Portali Lajmifundit sjell Lajme nga Shqipëria, rajoni dhe bota në kohë rekord. Ju lutemi na kontaktoni nëse doni të kontribuoni me informacione të vlefshme për publikim në portalin tonë.

[Kliko për më shumë informacion](#)

Euron pëson rënien si asnjëherë më parë, me sa tregtohet sot, këmbimi valutor 23 shtator 2026

[Lexo lajmin e plotë](#)

Skandali "Xhaka" merr përmasa të tjera, mjekja del kundër kapitenit: E kam vaksinuar vetë

[Lexo lajmin e plotë](#)

Zbulohet e vërteta për Bleona Matën, avokati: E ëma në gjendje të rëndë! A ndodhet në Greqi?!

[Lexo lajmin e plotë](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.